


KOSOVARIA

Ballina: Shukri Buja
me familje

SHUKRI BUJA:
Nuk flas për ndryshim,
kam për ta bërë atë!





Shërbimi

Rezonanca magnetike e gjinjëve

*Diagnostikim i avancuar, pa
dhimbje dhe pa rrezatim!*

+ 383 49 603 330

hospital@rezonanca-rks.com

Në ballinë: Shukri Buja, politikani i pakrahasueshëm

Nuk flas për ndryshim, kam për ta bërë atë!

Lipjani po përgatitet për një kapitull të ri në historinë e tij politike më zhvillimore. Shukri Buja, kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryetar të Komunës, ka shpallur rikthimin në skenën lokale me një mesazh të qartë: “Nuk flas për ndryshim, kam për ta bërë atë!”.

Në ballinë: Shukri Buja, politikani i pakrahasueshëm

Figura e Bujës nuk është e panjohur për qytetarët e Lipjanit. I rritur në një familje të madhe me shtatë vëllezër dhe tri motra, i ka përjetuar përplasjet e kohës dhe sfidat që solli jeta në Kosovë.

Me nofka që pasqyrojnë multifunksionalitetin e tij: "Shuki", "Kryetari", "Gjenerali", "Gazetari", Buja është një nga figurat më të njohura dhe më të respektuara të komunës së Lipjanit.

NË ADOLESHENCË NISI KAUZËN PËR LIRI...

Që në adoleshencë nisi kauzën për liri, duke udhëhequr protestat kundër regjimit serb dhe duke organizuar një grup gueril në kuadër të Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës. Për aktivitetin e tij u arrestua në vitin 1989 dhe u dënua me 13 vjet burg. "Në vitet 80, kur liria dhe të drejtat tona ishin të shtypura, unë isha në ballë të përballjes", thekson Shukri Buja, tash kandidat i PDK-së për kryetar të komunës së Lipjanit.

VEÇ AKTIVITETIT POLITIK – EDHE AFARIST I SUKSESSHËM

Gjatë luftës në Kosovë mori nofkën "Gazetari", shkaku i përvojës së tij si drejtor i gazetës "Zëri i Kosovës". Përveç aktivitetit politik dhe luftarak, Buja është edhe një afarist i suksesshëm, i njohur për aftësinë e tij për të menaxhuar projekte dhe

investime të mëdha, duke e bërë atë një figurë të plotë në biznes e politikë.

ISHTE DY MANDATE KRYETAR KOMUNE – SYNON MANDATIN E TRETË

Pas lufte Buja fitoi dy mandate si kryetar i Lipjanit dhe gjatë gjashtë viteve të qeverisjes investoi mbi 62 milionë

euro në infrastrukturën dhe zhvillimin e komunës.

Ai thekson se shumë punë janë bërë, por shumë më tepër ka mbetur për t'u realizuar.

"Fatkeqësisht, 12 vjetët e fundit kanë qenë vite të ngecjes, diskriminimit dhe moszhvillimit. Prandaj, edhe rikthehem", deklaroi ai.

Mesazhi i tij për qytetarët është i qartë: puna dhe projektet konkrete duhet të jenë në qendër të qeverisjes,



Shukriu gjatë pranimit të medaljes për kontributin e dhënë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës





jo fasadat politike.

Ai premton t'i çojë përpara projektet e papërfunduara dhe të zhvillojë projekte të reja që ndikojnë direkt në jetën e përditshme të qytetarëve.

I BESUESHËM DHE I RESPEKTUAR NGA POPULLI

Shukri Buja njihet, gjithashtu, si një njeri që e njeh Lipjanin "në arterie",

duke kuptuar nevojat dhe aspiratat e komunitetit.

Ai ka lënë gjurmë të rëndësishme në kohë dhe vazhdon të jetë një figurë e besueshme dhe e respektuar jo vetëm në politikë, por edhe në jetën publike dhe afariste të komunës.

"Unë nuk flas për ndryshim, por do e bëj atë! Lipjani ka nevojë për drejtim të vërtetë, për projekte që prekin jetën e përditshme, jo për fasadë apo

ngjyra. Tani është koha jonë!", thotë ai.

BABA DHE GJYSH I LUMTUR...

Përveç karrierës politike dhe afariste, Buja është edhe baba dhe gjysh i lumtur, duke e bërë figurën e tij një simbol stabiliteti dhe përkushtimi në të gjitha drejtimet. Suksese!

Gani Dili



Shukriu me familjen



Nga një kënd ndryshe...

Amerika është lodhur me ne!

Bota, e veçanërisht SHBA-të, janë lodhur me ne, sepse kërkesat dhe deklaratat e tyre politikanët tanë nuk i marrin seriozisht!

Merreni me mend në çfarë pozite kemi ardhur: Nga populli i viktimizuar që na shpëtuan vendet mike, sot jemi bërë horra e botës duke u shfaqur nëpër monitore televizive dhe portale e gazeta të huaja prestigjioze si popull që e ka në shpirt mashtrimin, gënjeshtërinë, hajninë! Pra, na ka rënë imazhi i viktimizuesit! Kështu, bota është lodhur me ne duke

ndërmjetësuar, madje jo vetëm me Serbinë!
Raportet e Qeverisë nuk janë aspak të mira as me Shqipërinë!
Shihni se çka po ndodh me formimin e Kuvendit të Kosovës?!
50 përpjekje për formimin e Kuvendit dhe asgjë, sepse këtë herë ambasadorët e shteteve të Perëndimit nuk po përzihen, meqë janë lodhur me ne!

FLASIM SHQIP E NUK KUPTOHEMI!

Gati gjysmë viti nuk kemi arritur të kuptohemi edhe pse ndërmjet veti flasim shqip! Andaj, edhe nuk është çudi pse ndërkombëtarët janë lodhur me ne...
E, për ta kuptuar më mirë këtë problem, po e ilustroj me një të vërtetë që mund të

përdoret si batutë:
Ishin zënë ndërmjet veti dy shqiptarë në një barakë në Slloveni, të cilët punonin atje.
Situata acarohet aq shumë sa nisin ta grushtonin njëri-tjetrin.
I treti ndërhyr duke i thënë njërit prej të acaruarve: "Fale bre burrë se keni ardhur për bukë të gojës e jo për luftë këtu!"
Dhe, kur sheh se i pari nuk lëshonte pe, të njëjtat fjalë ia thotë të dytit.
Por, kot...
Në fund, i mllëfosur, u thotë të dyve: "Copa u bëfshi!"
Andaj, meqë këtë herë ndërkombëtarët nuk u përfshinë në krijimin e Kuvendit të Kosovës, del se janë lodhur me ne...
Këq, a?

Selim Rama

PSE FJALËT E PLAKUT JANË ME VEND?

Përvoja e jetës lë shumëçka. Lë edhe mendime, thënie të vlefshme, të dobishme për çdo kohë e për çdo kë...



Fjalët e popullit, fjalët e plakut, fjalët e urta, shprehjet filozofike etj., të cilat i lexojmë, dëgjojmë apo i përfjethësojmë janë pjesë e jetës sonë. Thonë:

Nëse ke ushqim, rroba për veshje dhe kulm mbi kokë, je më i pasuri se 75 për qind e njerëzve të botës; Nëse i ke xhepat të fryrë me para, bën pjesë në 8 për qind të më të pasurve të botës; Nëse je zgjuar në mëngjes pa sëmundje, je më i bekuar se miliona njerëz anë e mbanë botës që nuk do ta mbijetojnë këtë javë; Nëse nuk ke përjetuar asnjëherë burgun, torturat apo kërcimin e urisë, je më fatlumi se 500 milionë vetë të gjallë në vuajtje; Nëse di shkrim-lexim je më fatlumi se 3 miliardë njerëz që nuk dinë!

*

Secili e ka jetën e vet: të mirë a të keqe, të varfër a të begatshme, të dhembshme a të lumtur... Secili e ka tregimin e vet të jetës. Secili i ka përjetimet e veta. Momentet e veta. Dashurinë e vet. Kujtimet e veta... Askush s'mund ta njehë shpirtin a zemrën tënde më shumë seç e njehë vetë. Askush s'mund ta njehë mendjen as synimin seç e njehë dhe e di vetë...

*

Kishte thënë njëri se ta gjykojë jetën a karakterin tim: Mbathi këpucët e mia dhe ec; Kalo rrugën që kalova unë; Jetoje skamjen time; Përfjethë lotin tim; Përfjethë qeshurat e mia; Përfjethë dashurinë time; Jeto vitet që jetova unë; Rrëzohu aty ku rashë unë; Ngrihu siç bëra unë!

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:
Gani DILI

Redaktor përgjegjës:
Isa ILAZI

Menaxher:
Driton DILI

Redaksia:
Safet Krivaça (reporter i lirë)
Nderim Neziri (redaktor)
Besiana Dili
Drenushë Haredinaj
Ardita Dili
Xheneta Spahiu

Dizajni:
Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:
Fahu postal 18, 10000 Prishtinë
Tel: 038 51 75 75
Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:
Tel: +383 44 143 448;
Email: marketing@kosovarja-ks.com

98 vjet nga vdekja...

Pse u la të vdesë në mjerim **Shote Galica?**

Para dy muajsh, konkretisht më 1 korrik, u bënë 98 vjet nga vdekja e Shote Galicës, heroinës më të madhe të kombit shqiptar.



Emri i vërtetë i Shote Galicës ishte Qerime Radisheva. U lind në fshatin Radishevë të Drenicës dhe u martua me Azem Galicën në vitin 1915.

U dallua për rolin e saj në kryengritjen e Dukagjinit dhe Junikut (1921-1923). Pas vdekjes së burrit të saj në vitin 1925, Shota mori drejtimin e luftës dhe luftoi së bashku me Bajram Currin në rajonet e Hasit, Prizrenit dhe Lumës.


E njohur për trimërinë dhe guximin e saj, ajo arriti të kapte një komandant serb dhe një numër ushtarësh në Çikatovë, duke dëshmuar aftësitë e saj të jashtëzakonshme luftarake.

Në korrik të vitit 1927, Shote Galica u tërhoq në Shqipëri dhe kaloi muajt e fundit të jetës në Fushë-Krujë, ku ndërroi jetë në moshë shumë të re, 31 vjeçe.

Ajo e përfundoi jetën në kushte shumë të rënda dhe në harresë totale, duke u përballur me sëmundje, varfëri dhe braktisje.

Për ekzistencë e shiti edhe kalin e saj, dhuratë nga Azem Galica!

Shote Galica ishte legjendë për kohën e saj. Mbahet mend edhe për thënien e saj të njohur: "Jeta pa dije është si një luftë pa armë!".



Petro Marko dhe Safos, në rini

Petro Marko i propozoi martesë femrës që e pa për herë të parë!

*Si mbahej gjallë
dashuria ndërmjet
Safos (piktore) dhe
Petro Markos (gazetar
e shkrimtar) gjatë qën-
dritit të tij në burg?*

Babai i Safos në ato vite lexon në gazeta emrin e Petro Markos. I thotë së bijës lexoje se ky është një poet i ri, krejt ndryshe. Dhe, për herë të parë Petro e Safo takohen në Kinemanë "17 Nëntori". Por, nuk ishte ndonjë takim me rëndësi veç një simpati e Petros për të... Më pas në Gazetën "Bashkimi" Safo shkon me një rekomandim pune. Aty edhe takohen, sepse kryeredaktor ishte Petro Marko. Petro e pyet: "A je e martuar?". "Jo!". "A je e dashuruar?". "Jo!". "Atëherë ti do të bëhesh gruaja ime!

Nuk ka më burrë se unë!". Por, kjo dashuri e Petros dhe e Safos kishte shumë sfida. Ai ka kaluar tortura të rënda, ndërkohë Petro kishte bërë burg edhe herë tjetër. "Një dashuri" - janë letrat që sollën në dritë forcën e zemrës dhe të mendjes ndërmjet Petro Markos dhe Safos gjatë qëndrimit të shkrimtarit në burg për 1096 ditë.

KU I SHKRUANTE PETRO MESAZHET E DASHURISË PËR SAFON?

Petro Marko ia shkruante Safos mesazhet e dashurisë në enët e ushqimit që ajo sillte për të, megjithëse ata nuk

takoheshin, nuk shiheshin. Safo e kupton këtë në çastin kur lante enët, komunikimi ishte i shkurtër, çuditërisht shkrimi i tyre ishte i njëjtë. Sidoqoftë, Safo kishte bukuri të rrallë, mirëpo nuk donte të mbahej mend për bukurinë, por për punën e saj. Mirëpo, në ato vite ishte dikush që e pëlqente Safon, megjithëse ajo e donte Petron. Ai ndërhyri mes tyre. Petro e takoi kandidatin tjetër dhe i tha që duhet t'i lëmë kohë Safos të zgjedhë. Dhe, i lanë kohë dy javë. Gjatë atyre ditëve Petro i çonte Safos lule dhe çokollata. Ai tjetri u dorëzua!



Kush po luan me popull?

Kosova është bërë fushë e lojës së kapuçave, që është luajtur në vendin tonë në oda. Fituesit kanë pasur të drejtë të shajnë, duke ua ofruar te hundët këmbët humbësve. Por, humbësit tanë që tash janë në politikë nuk hidhërohen, por janë pa ego!

Këta mendojnë se egoja është paraja! Mendojnë se ego është gjithçka tjetër pos dinjitetit dhe krenarisë njerëzore...

Dy telefonatat e së hënës ma prishën egon kah mesdita, kur dita e kësaj vere më dukej si në Saharë: Diell që përcëllon, barë i gjelbër askund!

Më kish kërkuar një njeri ca para borxh, sepse donte të paguante ca fatura të firmës së tij. Dhe, meqë nuk mund t'ia sigu-

roja, nuk e lajmërova fare...

Pas një jave më thirri në telefon dhe më tha se komunikimi që kishte ndodhur ndërmjet nesh e rëndonte, prandaj për ta ruajtur miqësinë kishte menduar t'më telefononte për kërkim-falje.

Unë e kuptova ironinë dhe i thashë se egoja ime nuk sh-

embej me një kërkim-faljeje ironike, meqë nuk i kisha borxh asgjë.

**E RUAJTA EGON,
SEPSE NUK I KISHA
BORXH!**

Më shkonin djersët ballit, por egon e ruajta, duke i thënë

vetes se isha në të drejtën time dhe për atë njeri kisha bërë shumëçka.

Kur ai e braktisi Hashim Thaçin, për të dalë në subjekte të tjera partiake, për ta mbështetur i shkova pas, duke e votuar si elektorat.

Elektorati hashimian më bëri kritika të rrepta që unë, si më i zjarri i grupit politik, e kisha braktisur Hashimin, sa këta kishin mbetur pa tekst.

Dhe, erdhi koha që ma hoq pendimin nga rruga që ecja... E, meqë ky farë burri më ironizonte me kërkim-falje pse s'i kisha huazuar lekë, egos sime i thashë: "Ngrite kokën dhe fol, ndjehu krenar dhe kujtoje të kaluarën e kritikave që më drejtoheshin në sy!

Fol dhe mos u dorëzo!
Fol dhe qëndro krenar, sepse ke bërë shumë për ta, kurse kurrë nuk ke fituar gjë prej tyre!"

Dhe, e kuptova se egoja kishte ngritur kokën dhe e bënte punën e vet të shenjtë, por shenjtëria sot nuk është vlerë!

VENDIN E SHENJTËRISË E KA ZËNË PARAJA!

Shenjtëria sot është kuantitet dhe vendin e saj e ka zënë paraja, e që është mollë sherri ndërmjet miqsh dhe shokësh. Megjithatë, egon nuk mund ta jepja për miqtë e mi, nuk mund ta shkelja për asgjë, sepse ishte krijuar me decenie në shtëpinë time, madje ende pa lindur unë, pa derën e oborrit kur babai priste miqtë e thyerjes së kufirit shqiptaro-shqiptar përg-

jatë brezit kufitar të Vërmicës, që mbeti me pak shtëpi nga një fshat me rreth 400 sosh sa ishte...

E mbyllëm debatin me mikun dhe arrita ta ruaja egon, nën djersët që më shkonin dhe këtë gjë e kuptova pasi miku kishte tentuar të ma lëndonte egon.

SI LUAJNË INSTRUKTORËT ME KANDIDATËT PËR SHOFRË?

Telefonata e dytë rrodhi nga një zë çuni, që po kërkonte ta prisja para auto-shkollës, e unë kurrë nuk kisha qenë instruktor. Ai foli e foli se si e kisha vonuar në përgatitje ta bëja shofer. I thashë se e keni gabuar numrin, por ajo që më lëndoi ishte se si luajnë instruktorët me kandidatët për shoferë...

E, se njerëzit pësojnë shkakun se kanë egon e tyre, po e tregoj me këtë shembull:

Po kaloja korridorit të një reparti spitalor në Prishtinë, kur një zë femre, që, me gjasë, ishte infermierja kryesore, i bërtiste një infermiereje tjetër, duke e ofenduar në prani të pacientëve.

Por, ajo e ruante egon e vet... E kjo ma kujtoi një moment të jetës sime: Kur isha student shkrova një përmbledhje poezish, të cilën ia dorëzova redaktorit Ali Podrimja.

Ai ende pa ia lëshuar shikimin, më tha: "Sado që të jenë poezitë të mira, nuk mund t'i botoj, sepse e kam para teje vazhën e një profesori, dekan fakulteti. Profa ishte një kritik

letrar jo i çmuar, ndërsa e bija kishte botuar ca poezi që nuk i lexonte askush! Sidoqoftë, ma mori rendin e botimit mua, që sapo kisha vënë këmbën në dyert e zyrave të poetëve, që mezi flisja para tyre, sepse më dukeshin të mëdhenj nga librat që i kisha lexuar ndër vite.

Unë mbeta pa libër, kurse e bija e dekanit u bë autore e një libri pavlerë!

S. Krivaça



Adem Gashi

Këndi i poezisë

Molla e kuqe


(Për muhaxhirët shqiptarë)

Na ishte njëherë e një kohë
një mollë e kuqe diku.
Paj,
edhe mund të mos ketë qenë,
veçse në kujtimet e vendasve
të përndjekur
pikon
gjak mallëngjimi e mos harresë.

Adem Gashi
Prishtinë, 12 korrik 2023

Epabesueshme, por e vërtetë...

Hija e Enver Hoxhës shëtiti natën nëpër vilë!



Ernesto Sabato

Ernesto Sabato mbetet një ndër shkrimtarët më të mëdhenj të botës dhe në deje kishte gjak shqiptari. Ai bëri një natë gjumë në vilën e Enver Hoxhës, por hija e Enverit i sillej nëpër vilë!

Ernesto Sabato u lind më 24 qershor 1911 dhe u nda nga jeta në moshën 100-vjeçare, më 30 prill 2011.

Por ai nuk donte të vdiste pa e parë Shqipërinë, vendin e origjinës së nënës së tij dhe mundësia i erdhi më 17 prill 1996.

Ishte hera e parë dhe e fundit që personaliteti më i madh i kulturës botërore kishte ardhur në Tiranë, në tokën e Arbrit.

Para se të merrte çmimin "Kadare", shkrimtari Visar Zhiti, i solli një grusht dhe nga trualli i arbëreshëve të Italisë. Gjatë qëndrimit në Tiranë ai u vendos në vilën e ish-diktatorit Enver Hoxha. Por, sipas dëshmisë së kohës, ai as nuk arriti të flinte, sepse u zgjua në mesnatë dhe doli prej aty, duke përfunduar në një nga hotelet e vjetra përreth qendrës së Tiranës së dikurshme.

I pyetur për këtë arratisje, Sabato do të rrëfente se natën kishte parë hije nëpër shtëpi...

"Jam kthyer nga Shqipëria ku u nderova me çmimin "Kadare".

Isha i dërmuar, por shkova atje për të

respektuar atë vend të varfër e heroik, i cili e jepte për herë parë për mua atë çmim.

Në qytetin e Tiranës m'u bënë nderimet më emocionuese në jetën time. Ky popull i vuajtur më priti si një mbrojtës, si një mbret, si birin e tij të dashur.

Në dorëzimin e këtij çmimi pati këngë dhe valle që s'do t'i harroj kurrë.

Shkrimtari shqiptar, Visar Zhiti, më dorëzoi një urnë me dhé që e kishte sjellë nga vendlindja e nënës sime.

Ai më tregoi një fletore që e kishte mbajtur fshehur në burg, me ca

germa të vogla kishte kopjuar një tekst nga Kamy dhe fragmentin "Djaloshi i dashur dhe i largët" nga libri im "Engjëlli i skëterrës".

Me lot në sy më tha se për shumë vjet që kishte qëndruar si i burgosur politik në qelitë e errëta, çdo ditë lexonte këto faqe, fshehtas, që të mund të rezistonte.

U trondita dhe u mallëngjeva njëherazi...

Kështu e përshkruan në librin autobiografik "Përpara fundit" Sabato vizitën e tij në Tiranë në vitin 1996...



Vila e Enver Hoxhës

DUO GRIND




POWER
HOUSE

Ku është Prelezi?

Të dielën e parë të këtij korriku me vapë tropikale, teksa po shkoja në drejtim të Ferizajt, te "Prishtina Mall" një femër ma bën me dorë në formë stopi. Dhe, e ndala veturën, me qëllim që ta pyesja se ku shkonte. Por, ajo pa një e pa dy u rras në veturën time...

"Si je o burrë, kah po shkon?", më tha posa u ul në karrigen e parë afër meje.

"Në Ferizaj", i them.

Pas pak vazhdova: "Të mora sepse po shkoj në drejtimin kah po shkon edhe ti, si duket...".

"Në rregull, por unë tashmë jam e rritur dhe futem në cilën veturë dua!", ma ktheu ajo.

"Më vjen mirë, por mos ma zë për të madhe se kam qëlluar paksa naiv e nuk i marr vesh këto sende shumë. E, sa vjeçe je?".

"Jam 22 vjeçe, e rritur".

"Ku shkon, ku e ke stacionin e fundit?".

"Stacionin e kam deri ku shkon edhe ti!

Shkoj ta pres një njeri!".

"E, ku do të zbresësh?".

"Zbres në Prelez".

"Ku është Prelezi?".

"Prelezi është në Prelez! Ku ka me qenë tjetër!", më thotë me nervozizëm.

Në çast, i cingëron telefoni.

"Mos më thirr ma në telefon se ta luaj nënën! Harroje këtë numër!", i thotë, duke e sharë dhe bërë horë dikë që unë nuk e dija kush ishte.

"Eu, do më zë belaja me të!", e solla në mendje.

EDHE GJYSHI HANË PASUL...

"Ani, djalë i mirë, çka ka të re kah ti?", më pyet sa për të thënë diçka.

"Mirë është çdo gjë, por unë nuk jam djalë i ri, jam gjysh i nipave e mbesave!", i thashë.

"Çka ka gajle që je gjysh?! Edhe gjyshit i

hahet pasuli!", më thotë me një qeshje të thellë.

"I kam bërë do vjet dhe i kam lënë këto punë, sepse duhet të ketë njeriu një stacion ku ndalet. Duhet ta ketë njeriu një Prelez si ti!".

"Ha-ha-ha, ti plak, a?!".

"Po, duhet të ruhet fytyra!", i them me krenari.

"A po ma ndal këtu veturën, pra?!".

"Po, si jo. Dhe, falë Zotit që po zbret!", i them unë.

E ndali veturën dhe ajo pa më përshëndetur del nga vetura. Lirohem prej saj dhe marr frymë lirshëm.

Lirohem nga një barrë që nuk më kishte ndodhur kurrë më parë në jetë, edhe pse kam udhëtuar shumë...

B. Bajrami



 anaderm





E paharrueshmja

Shpresa Berisha, e lindur në Suharekë, është këngëtare e njohur e muzikës së mirëfilltë popullore e viteve 70-80.

E ka kryer Fakultetin Juridik në Prishtinë.

Është femra e parë shqiptare në Suharekë që punoi si gjykatëse. Një kohë jetoj në Perëndim.

Tani është avokate.

Këngët e njohura të interpretuara nga Shpresa Berisha tematikë kanë patriotizmin, siç është kënga me titull "Prizerenit", por edhe këngë që i këndon dashurisë: "M'ka marrë malli shpirt", "Turtulleshë", "Të desha me hakikat" e të tjera.

Por, edhe këngë që i këndohen dhimbjes: "S' t'ja bëj hallit", "Për ty vuaj për ty këndo" e shumë të tjera.

Sidoqoftë, zëri i Shpresa Berishës ishte zë i ëmbël dhe me ëndje dëgjohet edhe tash nga adhuruesit e saj, sidomos nga nostalgjikët, njerëzit e kohës kur ajo ishte në kulminacionin e saj muzikor.





Giovanni's Beach



stourist
CAMPING



RESERVATIONS:
+382 69 336 233

mobile.apartments@gmail.com



Rexhë Hysen Berisha

Cili kosovar ishte spiun i CIA-s?

Rexhë Hysen Berisha në Gjermani ishte trajnuar nga një grup oficerësh amerikanë të CIA-së për zbarkim në Shqipëri e përmbysje të Enver Hoxhës. Ndërroi jetë më 22 shtator 2014, në vendlindje, në Novosellë të Pejës. Shteti amerikan pas 50 vjetësh i solli dekoratën dhe 35 mijë dollarë.

Më 17 dhjetor 2014, kur vizituam familjen Berisha në Novosellë të Pejës, Samiu, i biri i Rexhë Hysen Berishës, nga Novosella e Pejës, na priste në shtëpinë e tij modeste, me një oborr ngjitur me fushën e gjelbër dhjetë hektarësh të fshatit.

Shtëpinë e dikurshme ia kishin djegur në vitin 1999 forcat serbe, por e kishte rindërtuar pas lufte me rastin e investimeve që i erdhën nga një burim financiar i papritur nga SHBA-ja.

Aso kohe pesë vetë me uniforma amerikane e kishin kërkuar Rexhë Berishën, i cili edhe vetë kishte menduar se kontributi i tij dhënë dikur Amerikës tashmë veç ishte harruar...

PSE KISHIN ARDHUR USHTARËT AMERIKANË TA KËRKONIN NË NOVOSELLË REXHË BERISHËN PAS 50 VJETËSH?

Ata kishin ardhur me urdhër të Amerikës për ta nderuar me dekoratë të CIA-s (dekoratë që gjendet në shtëpinë e djalit të tij, Samiut), por edhe me një mbështetje materiale 35 dollarë.

Të dyja, pra, dekorata dhe ndihma në para,

për Rexhë Berishën nuk ishin, thjesht, vetëm dhurata...

Për më shumë se kaq, Rexhë Berisha zyrtarisht bëhet njeri domethënës, duke marrë epitetin e njeriut prestigjioz amerikan të agjunkturës së shërbimit më të fortë të SHBA-së, pasi që ishte ushtruar për diversione elitare të përmbysjes së regjimeve komuniste.

Zyrtarisht ishte agjent anglo-amerikan, që kishte ateruar në Shqipëri për ta rrëzuar pushtetin e Enver Hoxhës dhe ishte ndër të paktët që kishte shpëtuar pa u kapur dhe ekzekutuar.



KUSH ISHTE, NË FAKT, REXHË BERISHA I NOVOSELLËS SË PEJËS DHE SI U LARGUA NGA KOSOVA E ARRITI NË GREQI, ITALI E GJERMANI?

Patrioti Rexhë Berisha u lind më 14 mars 1918, në fshatin Novosellë e Pejës. Më 6 qershor 1943 u inkuadrua në Batalionin për diversantë "SS Skënderbeu". Me këtë batalion ai luftoi në shumë arena luftime kundër forcave çetnike në Mal të Zi (Plavë, Guci, Beranë e në vende të tjera). Me shpresën se do të bashkoheshin trojet shqiptare, e veçmas Kosova me Shqipërinë, ai në fillim të karrierës atdhetare punoi në gardën e xhandarmërisë, duke bashkëpunuar me Italinë dhe Gjermaninë. Një vit më vonë iu bashkua grupit prej 13 vetash, kryesisht të Ballit Kombëtar nga fshati Novosellë dhe u ngjiti në malet e Radavcit, duke u pozicionuar në shpellën mbi burimin e Drinit të Bardhë, e njohur si "Shpella e Bezdanit", vend prej nga mund të vëzhgoheshin ushtarakisht fshatrat e rrafshit: Novosella, Jabllanica, Vitomirica, Radavci etj. Në "Shpellën e Bezdanit" grupi, me mbështetjen e popullit, qëndroi një vit heroikisht. Në vitin 1945, pas një beteje me organet e shtetit, grupi i tij prej 50 luftëtarësh mësyu largimin nga shpella dhe mori rrugën për në Greqi. Grupi gjatë rrugës pësoi humbje në njerëz, meqë pritë pas pritë dhe luftë pas lufte u ndeshën me çetnikë e partizanë, ku shkak për humbje ishte edhe uria (mungesa e bukës). Pas shumë sfidave të luftës, Rexhë Hysen Berisha arriti në Greqi dhe prej aty në Itali, e më vonë depërtoi në Gjermani. Në Gjermani Rexhë Hysen Berisha u fut në strategjinë për çlirimin e Shqipërisë nga regjimi diktatorial komunist i Enver

Hoxhës, përcaktim i Shërbimit Sekret Britanik "M16", që ishte, kryesisht, shërbim që dominohej nga Shërbimi Inteligjent Amerikan CIA.

REXHË BERISHA USHTROHET PËR DIVERSANT

Duke treguar për shkathtësitë fizike të babait të vet në fazën e trajnimit për luftim në male, i biri i tij, Samiu thotë: "Babai ishte pjesë e një programi të veçantë amerikan-britanik për luftime në male dhe luftime në kushte e rrethana të veçanta në terren rural, gjë që i përshtatej futjes së tij në Shqipëri, ku edhe duhej të gjente mbështetës për rrëzimin e regjimit komunist të Enver Hoxhës. Ishte regjim që Perëndimi nuk e donte në Ballkan, sepse SHBA-të shtrinin ndikimin e tyre përballë Bashkimit Sovjetik. Në ato rrethana edhe ishte ushtruar babai im me oficerë amerikanë. Babai nuk na ka folur shumë për këto probleme, ngase nuk dëshironte të na ngarkonte me frikë, sepse edhe ashtu ishte nën përcjellje të UDB-ës dhe ishte marrë në pyetje dhjetëra herë për gjëra që u interesonin atyre. Është interesant fakti se kur shqiptarët e Kosovës e donin Enver Hoxhën, babai im e urrente haptazi. Rexha dhe grupi i tij i ishin nënshtruar një regjimi të disiplinuar të stërvitjeve. Eprorët i kishin urdhëruar ata që, pas zbarkimit në Shqipëri, të mos shtinë në qytetarë dhe të ikin nga mundësia e konfrontimit apo të urrejtjes. Grupi diversant përbëhej nga katër vetë: Rexhë Berisha, Halil Nerguti, Miftar Maloku dhe Ramadan Zejna nga Kukësi. Desanti i grupit është kryer në mesin e muajit nëntor të vitit 1949. Nuk ishte vetëm grupi i babait që kishte zbarkuar në Shqipëri. Më parë kishin zbarkuar dy grupe të tjera dhe që të dyja grupet ishin zënë nga ushtarët shqiptarë

dhe i kishin pushkatuar. Shërbimi inteligjent shqiptar ndihmohej nga rusët dhe kjo kishte bërë që të kapeshin diversantët në Shqipëri. Rexhë Berisha dhe grupi i tij kishin shpëtuar falë gabimit të pilotit, i cili i kishte lëshuar gabimisht me parashutë në malet mbi Tropojë, e që, me gjasë, organet shqiptare nuk ishin në dijeni... Dhe, dy vjet rresht, pra prej vitit 1949 e deri më 1951, grupi i Rexhë Berishës kishte bërë përpjekje t'i koordinonte punët me shqiptarë të Malësisë së Hasit, por nuk

arrijnë të gjejnë ithtarë për bashkëpunim, ani pse Malësia e Tropojës njihej si vend antikomunist.

Sidoqoftë, Rexhë Berisha me grupin e tij kishin jetuar dy vjet në malet e Hasit dhe më pas ishin drejtuar në drejtim të Kosovës, meqë amerikanët në radiolidhjet që i kishin u kishin propozuar të ktheheshin në Kosovë, në territorin e Jugosllavisë, meqë Jugosllavia ishte përcaktuar kundër Shqipërisë së Enver Hoxhës. Ata kishin kaluar në Prizren dhe me sugjerimin e një qytetari kishin shkuar në Çaçak të Serbisë, ku edhe qëndrojnë një vit, kinse si shtetas të Shqipërisë. Në Çaçak Rexhë Berisha ishte prezantuar me emrin Jakup Zogu, banor i Tiranës. Gjatë qëndrimit në Çaçak arrin të lidhet me qendrën e agjenturës së tij dhe vendosin të ktheheshin në Shqipëri për të filluar misionin e tyre, meqë mendonin se misioni mund të ishte i suksesshëm, por zbulohen nga forcat jugosllave dhe i mbajnë në burg një vit.

Dhe, meqë ishin në dijeni, CIA ndërhyr në sistemin e Jugosllavisë dhe ata lirohen nga burgu.

Rexhë Berisha kthehet në Novosellë dhe fillon të bëjë jetë duke siguruar bukën nga puna në bujqësi...

Një periudhë të jetës së vet e kaloi në varfëri.

Ai e përjetoi edhe luftën e vitit 1999, ku edhe iu dogj shtëpia tërësisht".

AMERIKANËT NUK E HARRUAN AGJENTIN E TYRE...

Por, amerikanët ishin ata që nuk e harruan. Paslufte i erdhën në vizitë një grup zyrtarësh ushtarakë të SHBA-së, duke i dhënë dekoratën e CIA-s, e edhe 35 mijë dollarë, e që i shfrytëzoi në rindërtimin e shtëpisë. Rexhë Berisha, agjenti i CIA-s, vdiq më 22 shtator 2014, në vendlindje, në Novosellë të Pejës.

Safet Krivaça

A janë prishur gratë, apo burrat?



Shpesh dëgjojmë se marrëdhëniet mes burrave dhe grave kanë ndryshuar rrënjësisht. Sidomos pas luftës, vlerat dhe dashuria duket sikur kanë ikur për l... Thuhet se kjo është pasojë e feminizmit, emancipimit apo konsumit masiv.

Por nëse kthehemi pas në histori, shohim se ajo që sot quajmë materializëm, në gjuhën shkencore përkufizohet me termin hipergami – një fjalë relativisht e re, por një fenomen shumë i vjetër, po aq sa vetë shoqëria njerëzore.

Që nga fiset e para e deri te qytetërimet antike, gratë kanë pasur prirjen të zgjedhin partnerë me status, siguri, pasuri, arsim ose potencial më të lartë se vetja. Kjo nuk është anomali moderne, por pjesë e natyrës njerëzore.

Edhe tek ne si popull, hipergamia ka qenë gjithmonë e pranishme në tregun e martesave, vetëm se në forma të tjera. Edhe para 100 vitesh, dhëndrri ideal i një shpie të mirë ishte ai burrë që konsiderohej i vlefshëm vetëm nëse:

- kishte tokë - pasuri dhe siguri,
- ishte mësues - status dhe respekt,
- më vonë, vetëm nëse kishte "letra" - mundësi për mirëqenie jashtë vendit.

Pra, edhe atëherë zgjedhja e partnerit lidhej më shumë me sigurinë dhe statusin, sesa me dashurinë.

Psikologjia evolucionare e shpjegon këtë si strategji mbijetese. Ndërsa psikologjia sociale flet për iluzionin e kontrollit, ku burrat besojnë se mund të sigurojnë dashuri të përjetshme përmes sakrificave të pafundme, por shpesh përfundojnë të varur nga gruaja vetë. Ky është rreziku i "të qenit rob i pasioneve".

Unë nuk dua të tingëlloj si filozofe, edhe pse ky është emri im i dytë, i lindur nga reagimi i babait tim kur, si vajzë e re, guxoja të shprehja mendim kritik. Në këtë temë delikate, e sidomos në kulturën tonë, dua t'i referohem filozofit tim të preferuar, Platonit. Në Politeia (Republika) dhe Nomoi (Ligjet) ai i trajtoi këto çështje shumë më përpara se bota të fliste për feminizëm apo barazi gjinore.

Në Nomoi, Platoni paralajmëron se dëshirat e pakontrolluara të grave mund të çojnë në destabilizim shoqëror – jo sepse gratë janë të këqija, por sepse strategjitë e tyre janë të orientuara nga mbijetesa dhe siguria. Në Politeia, ai përdor metaforën e "gënjeshtrës fisnike" – një iluzion i domosdoshëm për të mbajtur rendin në shoqëri. Por çfarë iluzioni duhet të besojmë sot për të mbajtur rend, së pari në shtëpi, se aty fillon belaja?

Një nga iluzionet më të mëdha, sipas meje, është ajo që quajmë "e vërteta" shqiptare se burri ka dominuar në shoqëri. Në realitet, gratë kanë ushtruar gjithmonë fuqi mbi burrat – jo përmes shpatës, por përmes ndikimit. Shkurt e shqip: edhe pse burri ishte koka, lëvizjet i drejtonte qafa, pra gruaja!

Në Simpozium, Platoni e përshkruan dashurinë si një shkallë: nga trupi, tek shpirti e deri te idealet. Gratë, thotë ai,

dinë të ngjiten pa mëshirë në këtë shkallë, ndërsa burri që ngec në hapin e parë mbetet gur shkeljeje. Sot kjo dukuri nuk është zhdukur, veç e kemi veshë me tesha të reja. Mjafton të hapësh Instagramin apo Facebook-un, ku burrat konkurrojnë me pasuri, me trup, me vetura luksoze e me status. Edhe aplikacionet e njohjeve janë kthyer në arena moderne gladiatorësh, ku burrat performojnë dhe gratë vlerësojnë.

Por kurthi i vërtetë nuk është natyra femërore. Është gënjeshtra se burri në këtë lojë mund të fitojë. I thonë: puno, shkollohu, vërteto veten, "bonu burrë" që të marrësh vëmendjen dhe besnikërinë e saj. Por sa më lart të ngjitesh, aq më e qartë bëhet se loja nuk është menduar të fitohet – por të të mbajë gjithmonë duke vrapuar.

Në thelb, marrëdhëniet janë transaksione të kushtëzuara nga nevojat dhe interesat. Shumica e burrave e kalojnë jetën duke kërkuar miratim nga jashtë – adhurimin e grave, duartrokitjet e shoqërisë – duke renditur trofetë bosh të një loje ku askush nuk i pyeti nëse duan të marrin pjesë.

Burimi i fuqisë së një burri nuk është kontrolli mbi gruan, por sundimi mbi vet-veten. Një burrë që lejon pasionet ta sundojnë, është një tiran në zinxhirë. Qëllimi yt duhet të jetë i panegociueshëm. Një grua mund të të shoqërojë në misionin tënd, por nuk duhet të jetë vetë misioni yt. Në momentin që ajo bëhet çmimi, ti veç ke humbur.

Platoni dhe psikologjia moderne thonë të njëjtën gjë: forca e burrit nuk qëndron te dominimi apo pronësimi, por te zotërimi i vetvetes.

Sidoqoftë, edhe këtu faji mbetet jetim. Por dilema ende ka mbetur pezull: a janë prishur gratë, apo burrat (baballarët) na prishën duke na edukuar — „hapi sytë e mos merr gjethqka, gjoje naj ven t' mirë se jeta osht e gatë".

Nga Platoni nuk mund të presim përgjigje, por ndoshta pak vetëreflektim na kish bërë mirë – të gjithëve, pa faj, pa turp e pa paragjykim. Nga përvoja ime personale dhe profesionale deri tani, kam konstatuar një gjë: asnjë burrë dhe asnjë grua nuk është shkatërruar nga martesja, por nga iluzioni që kishte për të.

Shkëndije Pacolli



**PRAXIS FÜR
PSYCHOLOGISCHE
BERATUNG**

Shkëndije Berisha Pacolli



+49 152 33 63 07 73



info@pacolli-praxis.de
www.pacolli-praxis.de



Boschring 6
56422 Wirges

Një mësues, veprimtar dhe frymëzim për atdheun



Recension i autobiografisë së Adem Shalës “Gjurmë të një jete”, botoi ART Club “Rifat Kukaj”, Prishtinë, 2025.

Autobiografia e Adem Shalës është më shumë se një rrëfim jete; është një epope e përkushtimit, sakrificës dhe dashurisë së thellë për Kosovën, gjuhën shqipe dhe identitetin kombëtar.

Në faqet e këtij libri lexuesi gjen historinë e një mësuesi të palodhur, që me zell dhe pasion ka ndërtuar urat e dijes në shkollën shqipe në Kosovë e në Gjermani, duke u bërë një stol i fortë për brezat e rinj që jetojnë larg atdheut.

Adem Shala është shembulli i rrallë i njeriut që jetën ia kushton misionit të madh të edukimit dhe ruajtjes së shpirtit kombëtar.

Me fjalët e tij ne ndjejmë dhimbjen e ndarjes nga toka amë, por edhe fuqinë e një dashurie që përballon çdo sfidë. Nxënësit e tij recitojnë me pasion vargjet e të madhit Gjergj Fishta:

“Dersa t’mundem me ligjrue,

E sa gjall me frymë un jam,

Kurr Shqypni s’kam me t’harrue,

Edhe n’vorr me t’përmend kam”.

Kjo dashuri për atdheun qëndron në themel të çdo veprimi të tij, duke i dhënë kuptim edhe sakrificës më të madhe – lëshimit të shtëpisë së tij personale në Sllatinë të Madhe për të mbajtur gjallë shkollën shqipe në Kosovën e okupuar në vitet nëntëdhjetë, një vend që për Adem Shalën është më shumë se një hapësirë fizike; është vendi ku rrënjët dhe shpresa mbijnë.

PËRPPJEKJA PËR TË RUAJTUR GJUHËN AMTARE TE FËMIJËT NË MËRGATË

Në autobiografi Adem Shala shpalosë kujtimet e tij për periudhën e rezistencës kombëtare, për përgatitjen e vështirë për luftë dhe për betejat e përditshme në emigrim, duke përshkruar si me dhimbje, ashtu edhe me krenari, rrugën e gjatë të migrimit në Gjermani.

Ai përshkruan me ndjenjë të thellë mallin për atdheun, një thirrje kjo që tingëllon si lutje për ringjalljen e një kombi, për mbijetesën e gjuhës dhe kulturës. Pasionet e tij për sportin dhe këngët shqiptare janë pjesë e shpirtit që ai ka mbajtur gjallë në çdo hap.

Këngët e Fatime Sokolit, me vargjet e tyre plot atdhedashuri, dhimbje dhe shpresë, kanë qenë një forcë e padukshme që e ka shoqëruar në çdo moment, duke i dhënë kurajë për të vazhduar misionin e tij:

“Moj Kosovë, moj kështjellë burrnje,

vend kryetrimash n’zemër rinie,

gjaku yt, gjaku i Skenderit,

Avdyl Frashërit e Ymer Prizrenit”.

Këto nota atdhetare janë jo vetëm muzika e fëmijërisë e rinisë së tij, por edhe mjet për t’u transmetuar brezave të rinj, për të ruajtur gjuhën dhe shpirtin shqiptar në mërgatë.

Një nga sfidat më të mëdha që shfaqet në autobiografi është përpjekja për të ruajtur gjuhën amtare te fëmijët në mërgim – një sfidë që Adem Shala e trajton me përkushtim të jashtëzakonshëm dhe që e quan mision jetësor.

Ai beson se pa gjuhë nuk ka identitet dhe pa identitet një popull humbet në kohë dhe hapësirë.

Prandaj, shkolla shqipe në Gjermani, e cila ka kaluar nëpër sfida të panumërta, është për të një kështjellë e pathyeshme.

DËSHMI E NJË JETE...

Autobiografia e Adem Shalës është një dëshmi e gjallë e një jete të shënjuar nga vështirësi të mëdha, sakrifica njerëzore dhe një dashuri të pashuar për atdheun dhe popullin e tij. Ajo është frymëzim për çdo shqiptar që përballon vështirësitë e mërgimit dhe i kujton të gjithëve se misioni për lirinë, arsimin dhe ruajtjen e identitetit nuk ndalet kurrë.

Nëpërmjet këtij rrëfimi Adem Shala ngjall në zemrat tona ndjenjën e krenarisë, mallit dhe besimit se çdo pengesë mund të kapërcehet me dashuri dhe punë të palodhur. Një kujtesë e fortë që, siç thonë edhe vargjet e një kënge të Vaçe Zelës, “Sa kemi mall, s’ka deti valë, o moj e bukura Shqipëri”.

Driton Gashi, publicist

EXCLUSIVE
GETAWAY

FAMILY

September



MARITIM MARINA BAY RESORT & CASINO

Rr. "Aleksandër Moisiu", Vlorë, Albania | +355 69 604 1000 | info@marinabay.al

A male rapper is performing on stage. He is wearing a white t-shirt with a red logo that says "WST BHT", a white baseball cap, and a watch on his left wrist. He is holding a microphone in his right hand and looking upwards. The background is a large screen displaying a blue and white abstract pattern. There are stage lights visible in the background.

BOOM

Lisi -
këngëtari "cool"
në listën e yjeve
të muzikës



Lisi - këngëtari "cool" *në listën e yjeve të muzikës*

Lisi është një ndër emrat e rinj që po bën karrierë në muzikën shqiptare. Ai po sjell një frymë të freskët në skenë, duke kombinuar energjinë rinore me përvojën e jetës jashtë vendit. Pas suksesit të projekteve të para dhe bashkëpunimit me emra të njohur, Lisi po konsolidohet si një artist që di çfarë do dhe ku po shkon...

Lisi, si lindi pasioni yt për muzikë dhe kur e ndjeve për herë të parë se je për skenë?

- Muzikën e kam pasion që kur isha fëmijë. Qysh herët kam filluar të performoj para shokëve dhe që atëherë e kuptova se skena ishte vendi im. Sot nuk është më thjesht pasion, është profesion dhe pjesë e pandashme e jetës sime...

Ti sapo ke sjell projektin më të ri "Jeta ime". Çfarë historie apo emozione përcjell me këtë këngë?

- "Jeta ime" është këngë që i dedikohet dashurisë dhe të rinjve. Kam dashur të tregoj emocionin e thjeshtë, por të fortë, që të gjithë e përjetojnë kur janë të dashuruar.

Është këngë me ndjenja, por dhe ritëm që lidh brezat...

Bashkëpunimi yt me Ermal Fejzulahun pat shumë sukses. Si erdhi ky bashkëpunim dhe çfarë ke mësuar nga bashkëpunimi me të?

- Ishte një bashkëpunim spontan, por shumë i veçantë. Publiku e priti jashtëzakonisht mirë dhe për mua ishte një privilegj të punoja me një artist si Ermal Fejzullahu.

Ai më ka dhënë shumë motivim për të punuar edhe më shumë, madje edhe për të besuar më shumë tek vetja.

Çfarë reagimesh ke marrë nga publiku për këngën "Jeta ime" dhe si ndihesh kur dëgjon komentet e fansave?

- Reagimet kanë qenë shumë pozitive.



Fjalët dhe komentet e fansave më japin energji dhe forcë për të ecur më tej.

Kur dëgjoj se muzika ime prek dikë, është shpërblimi më i madh për mua si artist.

Muzika sot është shumë konkurruese. Çfarë të veçon ty si artist nga të tjerët?

- Ka shumë talente të mirë, por ajo që më veçon është stili im. Unë luaj me gjuhën gjermanisht dhe shqip dhe gjithmonë mundohem të sjell diçka ndryshe, duke nxjerrë versionin më të mirë timin në çdo projekt.

A ka ndonjë moment në rrugëtimin tënd muzikor që e konsideron si pikë të suksesshme?

- Ka disa, por më të veçantat janë momentet kur më është dhënë mundësia të punoj me figura të mëdha të estradës. Janë çaste që të japin besim se je në rrugën e duhur...

Si e sheh veten pas disa vitesh në skenën muzikore shqiptare?

- Vetën e shoh me më shumë hite dhe me më shumë përvijë. Dua të rritem artistikisht dhe të jem pjesë e pandashme e skenës shqiptare...

A ke artist tjetër me të cilin ëndërron të bashkëpunosh?

- Ka shumë artistë të mirë. Nuk kam një emër të vetëm, sepse stili im përshtatet me shumë prej tyre. Për mua çdo bashkëpunim i mirë është një mundësi për të sjellë diçka të re.

Çfarë të frymëzon më shumë kur shkruan apo përzgjedh këngët?

Më frymëzon momenti kur i shkruaj. Tekstet vijnë nga përjetimet dhe ndjesitë që dua të ndaj me publikun. Është një proces shumë personal, por që lidhet drejtpërdrejt me njerëzit që e dëgjojnë...

Përveç muzikës, kush është Lisi në jetën e përditshme dhe si e kalon kohën jashtë studios?

- Jashtë studios jam shumë familjar. Shumicën e kohës e kaloj me familjen time të ngushtë, sepse ata janë baza dhe motivi im më i madh.

Të faleminderit!

- Faleminderit juve!

Nderim Neziri

Blerina Veseli ngjitet shkallëve të kalasë...

Aktorja Blerina Veseli, nga Vushtrria, që deri para pak kohësh pak shkruhej për të, me rolin e nuses në serialin “Nusja me shkollë” është bërë shumë e njohur për publikun e gjerë...

Aktorja e re nga Vushtrria, Blerina Veseli, ditë e më shumë po afirmohet me rolin e saj në serialin “Nusja me shkollë”, serial që po tërheq gjithnjë e më shumë shikues në mbarë vendin dhe është bërë një nga figurat më të dashura dhe më origjinale të ekranit. Blerina karrierën e saj e nisi në teatrin e Vushtrrisë dhe e ndërtoi nëpërmjet angazhimeve në projekte të ndryshme artistike, përfshirë serialin satirik “Schengen Visa” dhe një sërë skeçesh komike që kanë pasqyruar realitetin tonë me humor.

Me interpretim të natyrshëm Blerina po dëshmohej si aktore që veç po ngjitet sa më lart shkallëve për në kala.

Publiku vushtrrias, por jo vetëm vushtrrias, po ndjehet krenar për rrugëtimin e saj artistik, i cili nisi në qytetin e lindjes dhe tashmë po zgjerohet në nivel kombëtar.





BOOM

beauty

Vlora Ibrahim, gruaja që e ktheu pasionin për bukurinë në një histori frymëzuese

Purebeau
Black Diamond
WIRELESS FACIAL PEN

Vlora Ibrahimimi, gruaja që e ktheu pasionin për bukurinë në një histori frymëzuese

Vlora Ibrahimimi është ndër emrat që i ka dhënë një frymë të re botës së bukurisë në Prizren. Pasioni i saj i hershëm për krijimtarinë u kthye në profesion, në një biznes të suksesshëm që frymëzon shumë gra.

Me një histori të mbushur me sfida, ajo ka ndërtuar një rrugëtim ku pasioni, sinqeriteti dhe këmbëngulja janë bërë baza e suksesit.

Sot "Studio by Vlora" është histori e vërtetë suksesi dhe Vlora një shembull frymëzues...



Si nisi lidhja jote me botën e bukurisë?

- Lidhja ime me bukurinë ka nisur që në fëmijëri. Eksperimentoja me kukullat, me veten dhe me të afërmet. Ky pasion më dukej si një dhuratë e trashëguar nga nëna ime, e cila, edhe pse nuk e kishte profesion, kishte talent të veçantë për flokët. Nuk ishte rastësi – ishte dashuri e lindur për këtë fushë, që më vonë u bë profesion dhe mënyra ime e jetës...

Cila ka qenë sfida më e madhe në ngritjen e biznesit?

- Sfida më e madhe ishte të nis nga zero në një kohë shumë të vështirë për mua, kohë kur isha shtatzënë e më pas nënë e re. Mundësitë ishin të pakta, por ëndrrat të mëdha. Kishte ditë të lodhshme, por forca ime e brendshme, dashuria për punën dhe bindja se mund t'ia dal, më jepnin vullnet të mos ndalem. Ky udhëtim më mësoi se këmbëngulja dhe vullneti janë çelësi i suksesit...

Çfarë e dallon biznesin tënd nga të tjerat?

- Singleriteti. Gjithmonë ua kam thënë të vërtetën klienteve, qoftë për një trajtim apo rezultat. Ky komunikim i hapur ka krijuar besim dhe lidhje afatgjata. Shumë prej klienteve më janë bërë mike, sepse te unë nuk gjejnë vetëm shërbim, por një marrëdhënie njerëzore e ndërtuar me respekt e dashuri.

Ç'këshillë do i jepje dikujt që nis biznes në këtë fushë?

- Të mos ndalet... Çdo fillim është i vështirë, por besimi te vetja, puna e palodhur dhe pasioni janë thelbësore. Sfidat janë pjesë e rrugës, prandaj nuk duhet të dekurajohesh. Mua gjithmonë më ka udhëhequr fjalia: "Unë ja dal!". E, mu ky besim më ka dhënë forcë në çdo pengesë...

Çfarë shërbimesh ofroni?

- Studio ime ofron një gamë të plotë shërbimesh bukurie. Dikur i bëja të gjitha vetë, kurse tash kam një staf të trajnuar që kryen rreth 80% të punës duke ruajtur standardin. Ne nuk japim vetëm shërbim, por një përvojë të plotë bukurie, ku gjithçka bëhet me pasion dhe profesionalizëm.

A të ka ndryshuar puna në raport me mënyrën si e sheh bukurinë?

- Po. Dikur mendoja vetëm për pamjen e jashtme, tani e shoh më gjerë: si një përvojë që përfshin ndjenjën, qasjen dhe singleritetin. Bukuria nuk është vetëm rezultati që sheh në pasqyrë, por edhe energjia dhe dashuria që vendosim në punë.

Cili është rituali yt i përditshëm i kujdesit për veten?

- Jam e thjeshtë në rutinat e mia. Nuk e ekzagjeroj me produkte apo trajtime. Për mua kujdesi fillon nga brenda: të jem mirë me veten, të kem qasje pozitive dhe energji për të tjerët.

Si arrin të balancosh punën me familjen?

- Është sfidë e madhe, sidomos me katër fëmijë. E organizoj ditën time që të jem me ta në mëngjes e derisa të shkojnë në shkollë. Vetëm pasdite i përkushtohem plotësisht punës. Edhe klientet e mia më kuptojnë, gjë që e bën më të lehtë balancimin...

Kur lodhesh, si e kthen energjinë?

- E vërteta është se puna më jep energji të krijoj diçka të re, t'i shoh klientet të lumtura – kjo më bën të ndihem e plotësuar dhe më motivon çdo ditë.

Kush është gruaja që të ka frymëzuar më shumë?

- Nëna ime: e thjeshtë, e fortë dhe me shumë talent natyral. Ajo më ka treguar se bukuria nuk ka nevojë për tituj, por për pasion dhe dashuri.

A ke moto personale që të udhëheqë?

- Po. Motoja ime është: "Unë ja dal!". Është fjali e thjeshtë, por mban



brenda gjithë forcën dhe besimin që më ka shtyrë përpara në çdo moment të vështirë...

A e sheh veten si model për gjeneratën e re?

- Po. Them se me këmbëngulje, punë dhe besim, çdo ëndërr është e arritshme... Më pëlqen të lë pas një shembull që i motivon të rinjtë të ndjekin pasionin e tyre.

Çfarë nuk mungon kurrë në çantën tënde?

- Kam një çantë që e përdori që katër vjet pa e ndërruar. Është pjesë e stilit tim të thjeshtë dhe praktik. Përveç dokumenteve, në të nuk mbaj asgjë të panevojshme, e kjo tregon se thjeshtësia për mua është gjithmonë prioritet.

Nëse nuk do merreshe me bukurinë, me çka do merreshe?

- Kam filluar punën në moshën 17-vjeçare dhe kam kaluar nëpër shumë profesione: shitëse, menaxhere, librari, madje edhe punë të thjeshta. Këto më mësuhan të jem e disiplinuar dhe të kem përgjegjësi. Edhe sot, edhe pse jam pronare biznesi, nuk hezitoh të bëj çdo punë në detaje. Për mua asnjë punë nuk është e vështirë kur e bën me pasion...

Për fund, ç'mesazh ke?

- Duaje veten dhe puno shumë! Puna nuk të lodhë, por të bën më të fortë! Edhe kur rrëzohesh, ngrihu më e fortë dhe vazhdo! Kokën lart e me synim të qartë!

Nderim Neziri





Cilët biznesmenë rrahin gjoks se u kënaqën?

Pak fjalë për burrat kosovarë "të moralshëm", sidomos për disa biznesmenë se u kënaqën...

Temë që tashmë është lënë anash në Kosovë, por që vlon si "tamli në zjarr" është morali, sepse populli është dhënë pas politikës, e temat, siç është morali janë vetëm "biseda të fshehta" që bëhen ndërmjet "burrave të moralshëm" e "grave të moralshme".

Por, në këtë shkrim do të bëj fjalë vetëm për moralin e burrave, meqë janë të rrallë ata burra që nuk krekosen se u kënaqën dhe kanë "biografi" të pasur seksuale...

A JEMI SHOQËRI E MORALSHME?

Fakti se nuk debatohet haptazi, nuk do të thotë se jemi shoqëri e moralshme.

E, krekosja e burrave kosovarë se kanë "biografi të famshme seksuale", të krijon bindjen se nuk ka mbetur femër e virgjër në Kosovë!

Ndryshe, nuk mund të llogaritet dhe nuk mund të arsyetohet vepërimtaria "e bujshme" dhe "e pasur" e burrave kosovarë, e sidomos e disa biznesmenëve.

Sidoqoftë, tema për seksin në Kosovë edhe më tutje mbetet tabu.

Morali mbrohet me mbyllje të gojës...

Për moralin apo edhe për dukuritë amorale nuk debatohet në media apo nivele të tjera të komunikimit! Pse?

B. Bajrami



RE/MAX
LISSUS

RE/MAX LISSUS – Ekspertë të pasurive të paluajtshme
Ne lidhim njerëzit me shtëpinë e duhur, çdo ditë.



Rrjet global, rezultat lokal

Prania ndërkombëtare e RE/MAX dhe njohja e tregut vendor për maksimumin e mundësive tuaja.

Shërbime të plota

- Shitje & blerje rezidenciale
- Prona komerciale & investime
- Vlerësim & këshillim profesional

Transparencë & besim

Proces i qartë nga A në Zh, kontrata të sigurta dhe komunikim i vazhdueshëm.



Gent Kola

Agjent imobiliar • RE/MAX LISSUS

 /gent.kolaa

Gati për hapin tuaj të radhës në treg?

Na kontaktoni për një konsultë falas – ekipi ynë është gati t'ju udhëheqë.

RE/MAX LISSUS LEZHË

Located in Lezhë

Tel: +355 694020700





Dashnorët po më pengojnë të martohej!

Jam vajzë nga Mitrovica.

Të gjithë më thonë se jam e bukur, e veçmas ata me të cilët kam qenë në lidhje dashurie...

Të 40-at veç i kam kaluar.

Në shkollë të mesme, madje as në fakultet, nuk kam qenë e rehatshme... Kam pasur të dashur, madje jo një por disa sish...

Por, e keqja është se disa prej tyre edhe pas ndarjes nuk më kanë lënë rehat me vardisjet e tyre sa herë që i kam takuar, qoftë edhe rastësisht.

E, të tillët, fatkeqësisht, nuk po më lënë të martohej, kinse ende janë të dashuruar në mua!

A keni ndonjë këshillë që do më ndihmoj?

Faleminderit!

L. J., Klinë

Lidhja e gjatë që je me të dashurin e fundit, siç thekson në letrën tënde e nuk e përmendëm më lart, ka bërë që

të mos kesh ndjenja për ndonjë person tjetër, edhe pse me njërin ishe bukur e afërt në bisedë e takime. Por, ajo çka duhet të bësh është t'i lësh aventurat dhe të koncentrohesh vetëm në punë e familje, në mënyrë që ndjenjat tua të pushojnë e mendja të të qetësohet, ashtu që kur të fil-

losh lidhjen e re ta përjetosh si lidhje dashurie me synim martesën e jo aventurën...

Radio,
Lajme, Moti,
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin
Shkabaj për Android

ANDROID APP ON
Google play

bambé
kids shop

Miqësore
për lëkurën
& natyrën



Të punuara
me 100%
pambuk organik

 /bambe_kids_shop

Jeta ime si në seriale turke!

Me përjetimet e mia jeta ime ngjanë si në filma të serialeve turke. Pse?

Isha fëmija i parë në familjen tonë, nga 7 fëmijë sa i kishin prindërit e mi. Jetonim në kushte mizore. As bukën se kishim mjaftueshëm!

Andaj, si fëmija më i madh, barra për të siguruar kafshatën e gojës për vete dhe vëllezërit e motrat binte mbi mua...

Jeta jonë verore ishte nga mëngjesi në mbrëmje në fushë.

Pra, ag e terr..

E, kur isha 16 vjeçe krisi lufta. Ikëm në mal që ta shpëtonim kokën e prej aty në një fshat tjetër, pastaj në një tjetër derisa përfunduan ata tre muaj të tmerrshëm dhe u kthyem në shtëpitë tona.

Por, ku me u kthye, ore?!

Shtëpia ishte djegur. Vetëm oxhaqet kishin mbetur në këmbë.

Në oborr e vendosëm një shator të madh që na e dha si ndihmë një firmë e huaj.

Por, kur erdhi dimri duhej t'ia thernim dika, sepse në shator nuk mund ta kalonim dimrin.

Dhe, meqë nuk kishim ku të shkonim, para dimrit babai me vëllezërit e mi edhe pse të ri arritën t'ia bëjnë shtëpisë një kulm sa për të mos na hyrë bora brenda.

SHKOLLIMI I VONUAR...

Me vonesë iu bashkova edhe shoqeve e shokëve të shkollës, sepse edhe në ato kushte ëndrra ime ishte të bëhesha dikush në jetë...

E, kur erdhi koha e maturës: Çka të bëja?

Çka të vishja?

Dhe, që nga ajo kohë e deri tash sa herë që është koha e maturës më rrëqethet trupi, sepse ëndrra ime që edhe unë të isha në mesin e shoqeve e shokëve maturantë në mbrëmjen e maturës nuk më hiqet dot...

Pas kryerjes së maturës nuk u regjistrua në fakultet, sepse për qëndrim në Prishtinë nevojiteshin para.

Po atë kohë nisën të vinin mesitë në shtëpinë tonë t'më lypnin.

Ndërkohë u njoha me një djalë që vinte te fqinjët tanë, e që disa herë e vërja se më shikonte vjedhurazi.

Për këtë me kohë i tregova nënës, e cila më tha të mos flisja, sepse po të dinte babai do më fejonte me këdo veç për të mos pasur fjalë në fshatin tonë.

Një ditë babai e kishte pyetur nënën:

"Mos e ka çika naj kënd që nuk është e interesuar të fejojhet?!"

"Po, është në lidhje me një djalë që vjen te fqinjët tanë, por deri më tash nuk kanë asgjë ndërmjet vetil!", i kishte thënë ajo. Dhe, për habi, babai nuk kishte kundërshtuar siç e kishte zakon...

E, kur më tha nëna se babai nuk kishte bërë zhurmë, i qova fjalë atij djalit ta qonte mesitin t'më lyppte.

Dhe, ndodhi si ndodhi e u fejuam.

Ndërkohë babai nisi t'më mbante ligjëratë: "Nuk dua të të shoh as unë e askush tjetër me atë djalë as në rrugë madje pa u martuar!", më tha me zë të ashpër.

NUSE SI ËSHTË MË SË KEQI!

E, kur erdhi dita e martesës u bëra nuse. Në shtëpinë e tyre më kishte thënë se ishte ndryshe, se i kishin kushtet e jetës të mira. Dhe, kjo për mua kishte shumë rëndësi, sepse veç shpirti im e di çka kam hequr çdo verë në ara, në fushë...

Por, befasitë në jetë nuk mu hoqën asnjëherë.

Kur arrita në oborrin e shtëpisë së tij dhe pashë shtëpinë ku do jetoja, nuk më bënin këmbët të dilja prej veturës...

Dhe, ndodhi si ndodhi u krye dasma...

Erdhi mbrëmja dhe duhej të vinte dhëndri.

Kur erdhi, posa u larguan të pranishmit, i thashë: "Më paske gënjyer! Nuk më ke treguar se në ç'kushte jeton?!".

"Nuk të kam treguar, sepse nuk do martoheshe me mua! Por, as në shtëpinë tënde se ke pasur më mirë!", ma ktheu.


Dhe, nga ajo ditë e deri më sot të gjitha i përbiva, vetëm e vetëm që të mos ua nxirrja familjes faqen e zezë e fjalët të përhapeshin në fshat se iku gruaja e filanit e u kthye në familjen e saj...

Sidoqoftë, 5 vjetët e fundit u bëra edhe me fëmijë, por edhe burri nisi të punojë dhe u vendosëm në qytet.

Gjendja ka nisur të përmirësohet sado pak, edhe pse drita në fund të tunelit ende nuk shihet...

Shemsija, Podujevë

NË ZEMËR TË PRISHTINËS SË RE.



CIMA GRAND COMPLEX

PRISHTINA E RE

+383 49 509 090

Intimitet...



Edhe pse frikësohemi, *hera e parë është e pashmangshme!*

Kur putha për herë të parë
djaloshin e ëndrrave të mia, më
lëshoi zemra!

Merreni me mend: Të hutuar vësh-
tronim njëri-tjetrin në sy!
Pas pak më kapluan dridhjet...

Ç'po ndodh me mua? – thashë.
Nuk di! Edhe unë jam hutuar! – ma
ktheu.



Flasin gratë e martuara...

Vajzave të sotme u mungon sinqeriteti!

“Jam 68 vjeçe. Jam e lindur dhe e rritur në rrethinën e Deçanit, kurse e martuar në Pejë. Kam jetë të rehatshme familjare, meqë që nga dita e parë kur jam njohur me tim burrë kam qenë e sinqertë me të dhe krejt çka ka kërkuar prej meje i kam treguar drejt, pa dredhi, e jo si shumë vajza të sotme që sa thonë kështu e sa ashtu...”, thotë në bisedën tonë Ajetja, nënë e tre fëmijëve.

“Jam e martuar që 50 vjet në Pejë. Kam jetë të mirë falë sinqeritetit tim. Me burrë gjithmonë kam qenë e hapur dhe nuk i kam fshehur kurrë asgjë. Shkurt, çdo gjë e kam arritur me sinqeritet, sepse nuk kam qenë prej atyre femrave që e kanë zbuluar të kaluarën e tyre, siç bënin edhe në atë kohë shumë femra të tjera.

Zakonisht, më ka penguar një gjë: disa femra gjithmonë e kanë zbuluar të kaluarën e tyre sipas qejfit të tyre, e mua ai falsifikim nuk më ka pëlqyer. Përkundrazi, më kanë bërë nervoz femrat që u ka munguar origjinaliteti... Por, për fat të mirë në shoqërinë time nuk kam shoqe që gënjejnë, që lavdërohen, që aktrojnë dhe që të duan për interes.

Sidoqoftë, askujt s’ia kam lakmi për pasuri, sepse nuk kam jetë luksoze, por të gjitha që më duhet i kam, e kjo më përmbushë në çdo aspekt”, thotë për Revistën tonë Ajetja, e cila që gjysmë shekulli është e martuar dhe asnjëherë s’ka pasur as problemin më të vogël bashkëshortorë.

Diturie Haxhaj

Çka m'i ke ngul sytë, o plak?!

Sa herë që udhëtoj me autobusin numër 4, i cili kalon fund e krye Prishtinës (nga Pishina e Gërmisë e deri në fund të Lagjes "Mat"), njeriu jo vetëm që lodhet e stërlodhet nga rruga e gjatë dhe shumë e mundimshme me pritje në kolonë, sidomos të pjesa e ish-Pallatit të Shtypit "Rilindja", por edhe të kolonat e gjata me automjete të "Rrethi i Flamurit", konkretisht te vendi

që dikur prishtinasit e njihnin si rrethi të "Shkolla e mjekësisë", por edhe befasohet me atë sheh e ndodh...

Andaj, ta lëmë lodhjen e stërlodhjen e t'i kthemi një momenti kur një grua e re, e cila përgatitej të dilte nga autobusi në afërsi të ish-Shkollës Normale, një plak, lirisht mund të them matuf, s'e ndante shikimin dot kah ajo.

E, ajo, nga keqardhja nuk e ofendoj një kohë derisa edhe u nevrikos.

"A më njeh, a?!", i tha ajo.

"Jo valla", ia ktheu plaku matuf.

"E, çka m'i ke ngul sytë pra?!".

"Jo valla, s'di as vetë!", ia ktheu plaku.

Por, muhabeti nuk zgjati shumë, meqë autobusi u ndal në stacion e gruaja doli shpejt jashtë si "plumi i pushkës".



Çka kanë me treguar për jetën e tyre të rinjtë tanë?!

Ngjarja e dytë ndodhi, po ashtu, para pak ditësh, teksa e prisja autobusin numër 4 në drejtim të Gërmisë...

Para Gjimnazit, teksa prisja autobusin, një libër që e kisha me vete e lëshova mbi dërrasën ku u ula. Gruaja e cila veç priste autobusin para meje, rreth të 60-ave, zgjati dorën dhe e mori librin. Kur e lexoi titullin

e librit dhe emrin e autorit, tha:

"Nga është ky autor?"

"Nga Sllatina e Madhe", i thashë.

"Brezi yt e imi, së paku, kemi çka u tregojmë nipërve e mbesave..."

Mund t'u tregojmë se si fëmijë kemi luajtur në oborret tona deri vonë kur na thërrisnin prindërit të binim në gjumë.

I kemi lëshuar bagëtitë në livadhe.

Kemi lexuar libra e romane.

Kemi lexuar revista e çka jo tjetër...

E, brezi i tashëm?

Telefonin në dorë ag e mbrëmje!

Mjerim, a?", tha ajo teksa e shfletonte librin nga kureshtja.

Isa Ilazi

Revolucion në
DOBËSIM
Worldwide franchise



E themeluar në vitin 2011 nga Shkenda Dubova, me një qendër fillestare në Prishtinë.
Rrugëtimi ynë nisi në një kohë kur aparaturat nuk njiheshin në vendin tonë.
Qendra jonë solli një inovacion për tregun Kosovar dhe jo vetëm.
Kjo na bëri të ndihmojmë shumë njerëz duke përmbushur ëndrrat e tyre.



Rituali i kujdesit të lëkurës me L'Occitane:

Kujdesi i lëkurës me aromën e jugut të Francës

Me aromat e ngrohta, teksturat e lehta që përqafojnë lëkurën, L'Occitane En Provence ofron një përvojë të pasur dhe autentike të kujdesit për veten, frymëzuar nga natyra e Jugut të Francës. Marka ikonike franceze është simbol i luksit të qëndrueshëm dhe përkuqjesjes delikate, duke ofruar produkte që i përshtaten përkryer stinës së verës-nga kremrat e lehtë hidratues, te vajrat ushqyes për trupin dhe formulat eksperte të flokëve. Në këtë sezon të ndritshëm. L'Occitane është aleati ideal për një rutinë verore që ushqen, rigjallëron dhe mbron lëkurën nga dielli dhe i nxehti.



REINE BLANCHE UV SHIELD SPF50 30ML:

Mbroni lëkurën tuaj nga rrezet dëmshme të diellit ndërkohë që edhe e zbukuron atë me formulën multifunksionale të këtij kremi mbrojtës fytyre nga L'Occitane. Tekstura e tij e lehtë qumështore përthithet menjëherë nga lëkura dhe i ofron asaj benefite të shumëfishta si: mbrojtja maksimale ndaj rrezeve UV, hidratim, njëtrajtshmëri dhe përmirësimin të çehres.

OVERNIGHT RESET SERUM 30ML:

Të gjithë betohen për këtë serum, dhe kjo falë formulës së tij menjëherë efektive. Nuk do t'ju duhet të prisni gjatë, Overnight Reset Serum e jep efektin e tij të mrekullueshëm që pas natës së parë të përdorimit. Efektet që do t'i dashuron: lëkurë e feskët dhe me shkëlqim rinor, vija mimike më pak të dukshme, barrierë lëkure më e mbrojtur dhe më e shëndetshme, çehre më e qetë, rrathët e errët më pak të dukshëm. I përkryer për të gjitha tipet e lëkurës, është një produkt i domosdoshëm për tu patur në rutinë.





SHEA BUTTER ULTRA RICH BODY CREAM 200ML:

Ekspozimi ndaj temperaturave të larta shkakton dehidratim të lëkurës dhe prishje të barrierës së saj mbrojtëse, kjo rezulton në lëkurë më të thatë, pa shkëlqim dhe shpeshherë me ndjesi parehatie si kruarje, tërheqje apo irritim të lëkurës. Ky krem trupi është i pasuruar me 25% Gjalp Shea(kariteje) i cili ofron 72 orë hidratim dhe butësi afatgjatë për lëkurën. Me një butësi të mëndafshhtë dhe ndjesi rehatie, ky krem trupi është ajo që ju duhet këtë verë. Akoma më mire për ju; mund të përdoret nga e gjithë familja.



INTENSIVE REPAIR SHAMPOO 300ML

E fuqizuar nga vaji esencial i Angelica, proteina mikrobimore dhe fitoceramide mbrojtëse, kjo shampo është e përkryer për flokë (shumë) të thatë, të dëmtuar apo të lyer. Formula e saj pa silikon, rigjallëron fibrat e flokëve duke reduktuar këputjen e tyre dhe majat shumëfishe. Flokët rifitojnë shkëlqimin e shëndetshëm dhe mbeten të lëmuara e të trajtuara për më gjatë.

ALMOND SHOWER OIL 250ML

Një nga produktet më të dashura L'Occitane, me rekord shitjesh mbarë botën. Ky pastrues trupi është i pasuruar me vajin e bajameve të ëmbla nga Provanca dhe ka një funksion të dyfishtë për lëkurën; pastrues edhe hidratues. Tekstura e tij e vajore, kthehet në një shkumë të butë qumështore, menjëherë pasi bien ë kontakt me ujin. Këtë verë zgjidhni Almond Shower Oil për dushet më luksoze dhe lëkurën më të butë ndonjëherë. Këshillë: mund të përdoret edhe si bazë rroje.



ALMOND SUPPLE SKIN OIL 100ML

Një vaj trupi me efekt vezullues dhe lëmues për lëkurën, por me përfundim të thatë, pa krijuar ndjesi ngjitjeje apo parehatie. Duket si kombini ideal! Almond Supple Skin Oil është i pasuruar me vajin e Bajameve nga Provanca çka e bën një formulë shumë efikase si në rritjen e elasticitetit të lëkurës ashtu edhe trajtimin/parandalimin e strijave. Lëkurë e lëmuar, elastike, me butësi të mëndafshhtë dhe aromë të ngrohtë bajamesh dhe vanilje; një ndjesi që nuk do ta harroni!





I bëjmë qejf vetit, jetojmë me ëndrra!

Kishte shkuar një njeri i pasur nga qyteti në fshat për të kërkuar nuse për djalin e vet. Parim kishte që vajza me më së paku bërlllok në shtëpi do të bëhej nuse e djalit të tij...

Pasaniku hyn në një shtëpi dhe e pyet një vajzë:

"Kam ardhur t'ua marrë bërlllokun!"

"Po, kemi pak...," i thotë vajza.

"Kah të kthehem e marrë!," ia kthen ai.

Hyn në derën e dytë dhe njëjtë.

E, kur hyn në derën e tretë, një vajzë i thotë se në shtëpinë e saj nuk ka bërlllok, sepse ajo e pastron shtëpinë dy herë në ditë.

Andaj, mu ajo vajzë edhe bëhet nuse e të birit të tij...

Ky tregim i përgjigjet më së miri situatës së shtetit tonë, Republikës së

Kosovës.

Në Republikën e Kosovës nuk gjen sende të mira e të mbara, si ajo vajza pa bërlllok, por me bollëk gjen të këqija, madje sa të duash...

VETË KRITIKOJNË, VETË ABUZOJNË!

Mu ata që flasin e debatojnë çdo ditë për funksionimin e shtetit, mu ata më së shumti edhe abuzojnë me shtetin dhe mosfunksionimin e tij!

Prandaj, Kosova është vend i çudirave!

Pata shikuar serialin "Shekulli madhështor".

Para qindra vjetësh, sulltani i madhërishtëm, Sulejmani, ia hiqte kokën secilit nga stafi perandorak nëse kapej në hajni apo në ndonjë lloj krimi ekonomik.

Pra, e zbatonte ligjin që në atë kohë, para 600 vjetësh...

E, tash, në shekullin XXI, ende politikanët tanë nuk marrin asnjë lloj përgjegjësie për asnjë shkelje ligjore!

S.



MARIGONA
HILL



+383 49 162 000
+383 48 162 000
info@marigonahill.com

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depressive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Pse vera m'i zgjon emocionet?

Jam 50 vjeçe. Jetoj me fëmijë e burrë, e punësuar dhe kam jetë të qëndrueshme familjare dhe ekonomike.

Kam një problem se çdo verë ndjehem shumë më ndryshe se në çdo stinë tjetër! Bëhem shumë e ndjeshme shpirtërisht dhe qaj për pak.

Qysh kur kam qenë e vogël i kam pasur këto karakteristika, por me kalimin e viteve ato janë bërë edhe më të fuqishme në vend se t'më largohen!

Pse ndodh ky problem me mua?

"Dyshja, 50 vjeçe"

Përgjigje:

Ndjesinë shpirtërore dhe emotive në stinën më të nxehtë të vitit e kanë të gjithë njerëzit dhe e përjetojnë në mënyrën e vet. Asnjë qenie normale njerëzore nuk mund të mos joshet nga larja në det, rrezitja në plazh, shëtitja në male të larta si Brezovica e Rugova etj.

Është krejt normale përjetimi i kësaj dukurie, sado që te ti kjo rritje ndjeshmërie është zhvil-

luar më tepër, falë jetës së mirë në familje edhe në kohën kur ishe vajzë.

Romantizmi e forcon nostalgjinë, andaj edhe ti je bërë në mënyrë të natyrshme më reaguese ndaj kësaj dukurie. Ti, me siguri, e përcjell horoskopin që tregon personalitetin, shpirtin dhe rrethanat dhe të gjitha këto ndërliken me astrologjinë dhe ndryshimet që shkaktohen nga lëvizja planetare, pozita, stinët, yjet etj. Në tërësi, vera paraqet emocion të veçantë, por kur kjo kombinohet me ndonjë aventurë a nostalgji, gjendja shpirtërore mund të ngarkohet...

A është fëmija i burrit tim?

Jam 45 vjeçe, kam fëmijë dhe pata jetë të lumtur me burrë deri në momentin kur kuptova se ai ka një fëmijë me lidhje jashtëmartesore! Dua të di se a është e vërtetë se im burrë ka fëmijë me grua tjetër?

"Jam si pa krye..."

Përgjigje:

Përderisa burri nuk pranon se ka fëmijë me grua tjetër, s'ke

pse e mundon veten!

Nga parashikimi im për ty nuk shoh se yt burrë ka fëmijë tjetër veç atyre me ty...

A do të qetësohet vajza?

E kam një vajzë. Është 25 vjeçe. Kohëve të fundit është shumë nervoze.

Pse e ka gjithë atë nervozë?

"Nëna e brengosur"

Përgjigje:

Vajza ka një dashuri apo simpati të dështuar dhe ky rast ia ka ngritur nervat tej mase.

Por, me kalimin e kohës ajo do të bëhet vetvetja dhe do e ndryshojë qëndrimin e vet.

Pse dëshiron të ndahet burri prej meje?

Jam 44 vjeçe, jetoj në Zvicër. I kam tre fëmijë si drita.

Ka një vit që burri nuk fle me mua!

Jam munduar me iu afruar...

E kam pyetur a ka femër tjetër, por nuk e pranon se ka dikë.

Të lutem, si të veprojmë që ai t'më kthehet në shtrat?

"Naza"

Përgjigje:

Është në lidhje me një femër dhe janë në bisedë për martesë pas ndarjes suaj.

Por, mos u dorëzo, sepse fëmijët janë në anën tënde, e edhe ligjet e shtetit ku jeton të favorizojnë ty.

A do t'më kthehet nëse shkoj te ish-gruaja?

E nderuara magjistare, jam me shpresa të thyera. Kam jetuar shtatë vjet në Gjermani. Atje

isha i martuar me një polake, e cila edhe mban mbiemrin tim.

Mirëpo, mua mu mbush mendja të kthehem në Kosovë, kurse ajo vazhdoi të jetojë atje.

Ndarë nuk jemi...

A do jetojmë përsëri bashkë nëse unë kthehem në Gjermani?

"Më kanë humbur shpresat"

Përgjigje:

Edhe kur jeni martuar ti ke qenë një njeri me shtetësi të huaj për të.

Andaj, nëse shkon të punosh bën mirë, sepse e siguron ekzistencën familjare, kurse për të jetuar me të bashkë nuk besoj, sepse fill pas kthimit tënd në Kosovë ajo është lidhur me një tjetër dhe nuk besoj se e prishë rehatinë e saj...

Çfarë fati më pret?

E nderuara magjistare, dua të di se çfarë fati më pret dhe a do të vendosi dhe kur?

"Në pritje..."

Përgjigje:

Fati i një vajze 40 vjeçe siç je ti nuk mund të thuhet se është i lehtë në ditët tona.

Gjenerata jote ka ikur.

Sado që je e mirë është vështirë ta kapësh hapin e duhur të fatit.

Nuk bëhet fjalë që nuk ke oferta, por ajo çka po del te unë është se fati yt është i mbyllur dhe i pushtuar nga vështirësitë. Mirëpo, edhe kësaj pune do i vjen fundi dhe pak ditë para Vitit të Ri do të martohesh me

një person të cilit i ka vdekur gruaja dhe e ka një fëmijë...

Si do të jetë fati i familjes sime?

Jam 51-vjeçar. I kam dy djem e dy vajza. Jetoj në bashkësi familjare me vëllezër.

Dua të di se kur do ta kem shtëpinë time...

Ju përshëndes shumë.

"Shtëpia ime"

Përgjigje:

Bashkësia e gjerë familjare i takon stilit patriarkal që, zakonisht, vononi të futeni në jetën e kohës që jetoni. Në vend se të kujdeseni për familjen e ngushtë, ju duhet të merreni edhe me të tjerët, ashtu sikur edhe vëllezërit tuaj.

Shoh se po vonoheni ta kapni hapin, sepse një pjesë jete veç u ka kaluar...

Në këtë mënyrë, të gjithë familjarët janë peng tuaj dhe secili dëshiron të dalë nga ky stil familjar, sado që për shkak të rrethanave nuk e thonë para jush dëshirën për të qenë secila familje veç e veç.

Nuk kam fëmijë, çka tutje?

Jemi në martesë që shtatë vjet e nuk kemi fëmijë. Shkojmë rregullisht te mjeku, por nuk kemi sukses. Çka të bëjmë tutje?

"Fati..."

Përgjigje:

Letrës suaj i mungojnë detajet për një përgjigje të saktë dhe precize, sepse jemi në një problem që duhet t'i përafrohemi përveç parashikimit edhe me fakte konkrete.

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: "Kosovarja", fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

E, faktet janë analizat laboratorike të mjekut dhe gjendja juaj shpirtërore dhe fizike e bashkëshortore.

Po nisemi nga e para: Nëse analizat laboratorike tuat dhe të bashkëshortes kanë dal mirë (ana spermografike, kanalet e përçimit fekondues, cikli mujor, ovulacioni etj.), ju nuk keni punë me mjekësi dhe, mbi të gjitha, nuk jeni për trajtim mjekësor.

Është gjendja shpirtërore juaja pjesë e këtij sukseesi dhe dështimi, është ana stresore dhe nervore që, gjithashtu, mund të ketë dorë në dështim. Është lodhja juaj fizike dhe puna profesionale që bëni etj. Pra, të gjitha këto elemente janë pjesë e këtij procesi. Prandaj, ju nuk m'i keni shënuar detajet komplete të problemeve që kanë dal te ju gjatë procesit të analizave.

Megjithatë, unë mund t'u sugjeroj kështu: Nëse analizat tregojnë se keni probleme konkrete, vazhdoni trajtimin me ekspertë mjekësorë dhe gjinekologë. Respektojeni mendimin e tyre dhe zbatoni trajtimin.

E, nëse mjekët nuk kanë gjetur detaje për trajtim, atëherë kërkoni edhe masa plotësuese alternative dhe jashtë mjekësore...



NË SHITJE

Vila

www.agikons.com

+355 68 407 6883



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE



Prof. Asoc. Dr FEHIM HALITI



Part of DENTFIX GROUP



@dentfix ks

+383 44 22 55 34

www.dentfix-ks.com

Ahmet Krasniqi Str. No 137,
Pristina, Kosovo



CARE & HAIR FIX
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC

